



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 2156/2 Prot

Fier më, 27 02 /2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 27.02.2024. Sot në sallën e mbledhjeve ora 12:00. Të pranishëm në mbledhje 37 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përshëndetje të nderuar këshilltarë ! Jemi në mbledhjen e radhës. Meqënëse Sekretari i Këshillit konfirmon ekzistencën e kuorumit, fillojmë mbledhjen. Rendi i ditës ju ka ardhur në mënyrë elektronike. Në rendin e ditës pika 7(shtatë), Projekt - vendim: “Për shpërndarjen e 3 banesave sociale me qira, të cilat rezultojnë të lira nga menaxhimi i banesave sociale me qira pranë bllokut të Banesave Sociale Lagjja "16 Prili" Fier, për 3 familje të pastreha" dhe pika 9(nëntë) Kërkesë “ Për dhënie ndihme të menjëherëshme Arqile Lipe “, hiqen nga rendi i ditës nga administrata për plotësim dokumentacioni. Dhe futen dy pika shtesë në rendin e ditës që janë :

1. Projekt vendim “Për miratimin e planvendosjes së strukturës për projektin “ Rehabilitimi i Lumit Gjanica Faza 3 , Fier” per efekt të vazhimit të procedurave për pajisjen me leje infrastrukture dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik”

2. Projekt vendim “Për dhënien e miratimit për prishjen e objektit “vendstrehim” me sipërfaqe 135 m<sup>2</sup>, me nr. inventari 664, zk. 8531, që preket nga projekti “Shtesë anësore 1 kt në objekt ekzistues 3 kt, shkolla 9 vjeçare “Liri Gero” lagja “11 Janari” Fier, për ndërtimin e palestrës së shkollës si dhe nxjerrjen nga inventari të kësaj pasurie”

Të dyja këto projekt vendime ju kanë ardhur në mënyrë elektronike. Fillimisht miratojmë rendin e ditës së bashku me dy pikat shtesë që u përmendën më sipër. Po Endri, fol.

Z. Endri Jaupaj

Në lidhje me pikat shtesë të rendit të ditës, janë mbledhur komisionet? I kanë diskutuar? I kanë bërë relacionet përkatëse dhe i dispononi ju këto relacione? Sepse roli juaj është të drejtoni seancën dhe jo të shpjegoni pikat e rendit të ditës, për këto janë komisionet dhe administrata.

Znj. Antoneta Çunaj

Në momentin që ne do miratojmë secilën prej pikave të rendit të ditës, unë do ti jap fillimisht të drejtën e fjalës përfaqësuesve të administratës, përfaqësuesve të komisioneve dhe më pas do të diskutojë secili prej këshilltarëve.

Z. Endri Jaupaj

Relacionin e secilit prej komisioneve duhet ta kishit ju.

Znj. Antoneta Çunaj

Komisionet do të relatojnë vetë.

Z.Endri Jaupaj

Po ju kujtoj nenin 35 të rregullore "Funksionimin e komisioneve të përhershëm": "Çdo çështje përpara se të shqyrtohet në mbledhjen e këshillit, duhet të shqyrtohet më parë në komisionin e përhershëm përkatës, i cili jep një vendim në lidhje me çështjen. Mosparaqitja në mbledhjen e komisionit të përhershëm të projekt akteve dhe rezolutave për shqyrtim paraprak, është pengesë për ta kaluar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e këshillit". Këtë nen e keni pjesë të rregullores që e keni miratuar me unanimitet të plotë në këshill, nga ana juaj si pozitë. Dhe propozimit që ju ka ardhur nga "Bashkitë e Forta" për të tërhequr materialet jepini kohë, pasi "bashkitë e forta" nuk kanë pse ti marrin këto materiale, sepse ne mund ta negociojmë këtë problemin e transmetimit live, i cili vajti histori e gjatë që prej ditës së konstituimit e deri tani, pasi ju jeni përgjegjëse për transmetimin live. A ka ndonjë përgjigje për këtë, sepse ta kam kërkuar që në mbledhjen e parë?

Znj.Antoneta Çunaj

Mua nuk më ka ardhur asnjë informacion zyrtar në lidhje me këtë kërkesë të "Bashkive të Forta", që sapo paraqite ti. Në këshillin bashkiak nuk është protokolluar asnjë kërkesë apo ankesë nga "Bashkitë e Forta" në lidhje me atë problem apo pretendim që sapo ngritët ju.

Z.Arnando Çupa

M,q,s u përmend emri i sekretarit të këshillit, atëherë unë jam i detyruar të flasë. Kërkesë zyrtare në protokollin e bashkisë Fier, e cila më pas vjen në sekretariatit e këshillit bashkiak, nuk ka.

Z.Endri Jaupaj

Po në mënyrë informale a jeni vënë në dijeni?

Z.Arnando Çupa

Nuk po diskutojmë këtu për mënyrën informale, nuk veprojmë në informalitet. Ne jemi institucion ligjor dhe bazohemi në ligj dhe rregullore, siç e kërkon edhe ju vazhdimisht si opozitë.dhe po e përsërisë edhe njëherë që nuk ka asnjë kërkesë zyrtare apo informacion zyrtar në lidhje me pretendimin e ngritur nga ana juaj zoti Jaupaj.

Znj.Evisa Sema

Kryetare, në respekt të kohës së gjithë secilit dhe për të vlerësuar e për të mos ulur inteligjencën e secilit, e vendosim sot dhe të mos diskutojmë më këto gjëra sepse janë përsëritur shumë herë:Së pari.Për sa i përket komisioneve, jemi dakort me faktin që në rregullore thuhet që mos mbledhja e komisioneve përbën pengesë por nuk do të thotë që nëse nuk janë mbledhur komisionet nuk do të mbledhet edhe këshilli, pra gjithë ne të tjerët sepse i bie që këtu në mbledhje të këshillit të qëndrojnë vetëm ata që janë anëtar të komisioneve që duhet të ishin mbledhur për të trajtuar pikat e mbledhjes së sotme dhe ne të tjerët të mos ishim fare.

Z.Endri Jaupaj

Ti personalisht je pengesa kryesore për mosmbledhjen e komisioneve pasi je kryetare e grupit të këshilltarëve të mazhorancës.

Znj.Evisa Sema

Kryetrare të lutem. Në momentin që keni hedhur për miratim rendin e ditës, mos lejoni më ndërhyrje për të trajtuar çështje që janë jashtë rendit të ditës. Këtë problem e kanë ngritur edhe Prefektura, gjë e cila u bë prezente nga ana juaj edhe në mbledhjen e kaluar.

### **Pika e parë e rendit të ditës.**

Miratimi i rendit të ditës.

Znj. Antoneta Çunaj

Hedhim në votim rendin e ditës. Po inxhinier.

Z. Ilia Fili

Po e kërkoj fjalën për këtë problematikë pasi këtë e kemi trajtuar edhe në mbledhjet e mëparëshme. Materialet duhet ti paraqiten këshilltarëve të paktën 5 (pesë) ditë përpara ditës së mbledhjes. N.q.s këto material jënë paraqitur brenda këtij 5 ditëshi, ne po i pranuar ne kemi shkelur rregulloren. Unë dakort jam edhe me argumentimin tuaj se ka edhe raste emergjence apo edhe raste përjashtimore por ama nqs ka një rregull, dhe ne kemi një rregullore, e para duhet të jeni ju që të vendosni zbatimin e kësaj rregullore dhe mos ti pranoni për shqyrtim këto material. Unë e kuptoj dhe nuk ja vendos dot fajin sekretariatit të këshillit sepse nuk e ka fajin sekretariati jonë por e kanë fajin njësitë e administratës të cilat nuk përgatisin materialet më herët që ti paraqesin pranë sekretariatit të këshillit, duke respektuar kështu afatin ligjor. Kaq e vështirë qënka për të përgatitur, gjetur dhe grumbulluar materialet e për ti çuar në sekretari materialet për këto dy pikat shtesë për të cilat materialet na kanë ardhur jashtë afatit ligjor? Ja ku janë punonjësit e administratës le të përgjigjen, pasi vihemi ne si këshill tani në një situatë të tillë të vështirë për shkak të kësaj mangësie të përsëritur nga ana e administratës. Unë një gjë të tillë nuk e kuptoj. Do vijmë më pas tek pika e informacionit apo analizës financiare të cilën e kemi si pikë të fundit të rendit të ditës, e cila me sa u interesova është mbi njëqind e ca faqe, e cila është thjesht informacion sipas asaj që keni paraqitur dhe unë pyes: Nëse është informacion përse e sillni tek ne?

Znj. Antoneta Çunaj

Për cilën analizë financiare e keni fjalën? Unë jua thashë të nderuar këshilltarë me sa di unë për të dyja këto pika shtesë e sidomos për prishjes e arij objekti në oborrin e shkollë, na ka ardhur tani miratimi nga ministria përkatëse gjith do të flasin përfaqësuesit e bashkisë si qëndron problem që këto dy project vendime janë paraqitur jashtë afatit ligjor.

Znj. Evisa Sema

Kryetare të lutem mirato rendin e ditës së bashku me pikat shtesë dhe kur të vijë momenti I diskutimit të këtyre pikave shtesë të marrin sqarimet përkatëse nga ana e administratës për moszbatimin e afatit.

Z. Endri Jaupaj

Po nuk mund të ecet me miratimin dhe futjen e këtyre dy pikave shtesë në rendin e ditës pasi janë shkelur afatet për paraqitjen e tyre dhe ju nuk mund të procedoni më tej duke vazhduar të shkëlmi rregulloren. dhe për sa I përket të drejtës së fjalës juve si mazhorancë mund të vazhdoni të bëni ligjin me forcën e kartonit, por nuk mund ti hiqni të drejtën e fjalës opozitës pasi ne vetëm të drejtën e fjalës kemi në këtë këshill se kartonat I keni ju.

Z. Arben Çuko

Me sa u vura në dijeni nga kolegu Jaupaj që ka ardhur kërkesë nga bashkitë e forta që nëse nuk bëhet I mundur transmetimi live i mbledhjeve, atëherë ata do të tërheqin materialet pra infrastrukturën që kanë sjellë pranë këshillit bahkiak për të bërë të mundur këtë transmetim live. Siç e dini ne kemi bërë kërkesë që në fillim si subject politik për të bërë të mundur transmetimin live. Kërkesë e cila nuk është zbatuar deri tani. Dhe nëse ju e keni marrë me të qeshur atëherë ne që deri tani ju kemi shtritur dorën e bashkëpunimit si mazhorancë, do të sillemi ndryshe dhe do të shkojmë deri në veprimin ekstrem të tërheqjes së grupit të këshilltarëve tanë në mënyrë përfundimtare nga mbledhjet e këshillit, deri sat ë realizohet transmetimi live I mbledhjeve.

Znj. Antoneta Çunaj

Është e drejta juaj që të veproni ashtu si ta mendoni. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës së bashku me dy project vendimet shtesë. Kush është dakort?

Pro 31 vota.

Abstenim 3 vota.

Kundra 3 vota.

Miratohet .

#### **Pika e dytë e rendit të ditës.**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.01.2025

Znj. Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.01.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dokort ?

Pro 35 vota

Kundra 1 votë

Abstenim 1 votë

Miratohet.

#### **Pika e tretë e rendit të ditës**

Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Janar 2025"

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht do të flasi përfaqësuesi i bashkisë, më pas komisioni përkatës nëse është mbledhur dhe pas këtij momenti çdo këshilltarë ka të drejtë të flaji në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës.

Znj. Merita Bitri

Për muajin janar janë rekomanduar 49 familje në skemën e 6%. Në ndryshim nga muaji i mëparshëm janë hequr 5 familje, arsyja është sepse kanë aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike në sistem dhe futen 7 familje të cilat janë në gjendje të dobët ekonomike, kryesisht gra kryefamiljare, të vetmuara, me fëmijë. Në total 49 familje me një fond prej 219236 lekë.

Z.Melsi Bogdani

Drejtoreshë, këta që hiqen nga skema e 6% për arsye të sistemit, konkretisht për se hiqen?

Znj.Merita Bitri

Këta hiqen nga skema nga ana e sistemit për tu verifikuar nëse i plotësojnë kriteret apo jo.

Z.Melsi Bogdani

Pas verifikimit i marrin këto pjesët e prapambetura?

Znj.Merita Bitri

Cilën pjesë të prapambetur?

Z.Melsi Bogdani

Këtë muaj që kanë dalë nga skema.

Znj.Merita Bitri

Jo, nuk e marrin.

Znj.Antoneta Çunaj

Komisioni përkatës është mbledhur në lidhje me këtë pikë?

Z.Elvi Daka

Përshëndetje kryetare, kolegë! Në fakt komisioni mbledhet çdo muaj për pjesën e 6% pasi kjo është një e drejtë ligjore që kanë bashkitë për të identifikuar familjet e reja që hyjnë në këtë skemë. E vetmja gjë që mbetet problem dhe këtu kemi marrë edhe pëlqimin dhe votën e minorancës, është fakti që është një vlerë shumë e ulët me të cilën këto familje trajtohen por kjo është një vlerë e përcaktuar me VKM dhe nuk mund të ndryshohen nga ana jonë. Pra po ta shikosh sipas përlllogaritjes duke pjestuar fondin e përgjithshëm me numrin e familjeve përfituese, del që çdo familje përfiton 3000 deri në 5000 lekë maksimumi në varësi të numrit të anëtarëve. Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionet që i është paraqitur nga ana e administratës për këtë çështje dhe është çdo gjë në rregull dhe ja kalon këshillit për miratim.

Znj.Antoneta Çunaj

Dëshiron ndonjë anëtar të flasë në lidhje me këtë problem? Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

E kam shtruar edhe kur diskutuam ndihmën që dhamë për 1200 familjet përpara vitit të ri por konstatoj edhe këtu tek dokumenti që na është paraqitur, personat që futen në ndihmë ekonomike, 5(pesë) janë zonja dhe 2(dy) janë burra, ndërsa nga ata që dalin 4(katër) janë zonja dhe 1(një) është burrë. Pyetja ime është, këto zonja janë kryefamiljare apo kanë ndonjë specifikë të veçantë?

Z.Elvi Daka

Po, janë kryefamiljare.

Znj.Antoneta Çunaj

E hrdhim në votim.Kush është pro?

Pro 37 vota

Kundra nuk ka

Abstenim nuk ka.

Miratohet

**Pika e katërt e rendit të ditës.**

Projekt vendim: “Për shtesë nga të ardhurat e trashëguara në Buxhetin e Bashkise Fier për vitin 2025”

Znj.Antoneta Çunaj

Fjalën e ka përfaqësuesja e bashkisë.

Znj.Pranvera Cina

Nga aktrakordimi që kemi bërë me degën e thesarit për fonden që mbarten nga viti 2024 në vitin 2025 dhe në bazë të shpërndarjeve që kemi bërë në mbledhjet e mëparëshme, mbetet pa u shpërndarë fondi 438 milion 403 mijë dhe sipas nevojave dhe objektivave që ka bashkia e Fierit së bashku me ndërrmarjet vartëse është bërë shpërndarja sipas programeve shpenzuese.Ndërkohë këtu kemi future edhe një seri projektesh të cilat janë kërkuar nga komuniteti kur kemi bërë dëgjesat publike në periudhën tetor-nëntor 2024 dhe për efekt fondesh nuk janë futur në buxhetin fillestar.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën? Po inxhinier

Z.Ilia Fili

Për se bëhet fjalë në këtë rast konkret?

Znj.Pranvera Cina

Për fondet e trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025.

Znj.Antoneta Çunaj

Nëse komisioni i ekonomisë është mbledhur dëshiron ndonjë përfaqësues I këtij komisioni të marri fjalën?

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni i ekonomisë nuk është mbledhur për arsye shëndetësore.

Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit! Atëherë vazhdo inxhinier.

Z.Ilia Fili

Pasi e pashë materialin sapo më ra në dorë, pyetja ime e parë natyrisht pa përgjigje është: Na vjen një buxhet që ka ngelur nga viti 2024 dhe kapërcen në vitin 2025, pse lind pyetja? Pse ka ngelur ky buxhet? Ç'është ky buxhet që ka ngelur pa shfrytëzuar dhe na kapërcen në vitin 2025. A ka ndonjë analizë këtu? Kur ne në këshill miratojmë buxhetin, miratojmë të gjitha zërat, miratojmë investimet, miratojmë shpenzimet operative, miratojmë pagat dhe na dalin tani që ne kapërcejmë buxhete nga viti në vit dhe me aq sa pashë unë, vetëm nga zëri i nvestime ishte një shumë goxha e madhe. Unë personalisht për këtë punë kam ardhur në këshill, të gjurmojë, të ndjekë, të insistojë për investimet kapitale në bashkinë e Fierit. Mua nuk më pëlqen dhe nuk jam aspak entuziastë që këto fonde po shkojnë në buxhetin e 2025, ndërkohë që nuk kemi asnjë lloj analize pse nuk u realizua ky buxhet në vitin 2024. Unë mendoj që kjo është një nga problematikat më themelore dhe një nga çështjet më kryesore që prekin këtë bashki. Nqs duam të jemi serioz dhe të vëmë pikat mbi "i" analiza duhet të fillojë pikërisht këtu.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit i nderuar këshilltarë, por personalisht them që është gjë e mirë për ne që ka ngelur një sasi të ardhurash nga viti i kaluar e cila nuk humbet por kalon në këtë vit, e para kjo. E dyta. Ka një gjë, investimet ka rate që mund të mos bëhen edhe për arsye objektive, por nuk është kjo thelbësorja. Rëndësi ka që ky buxhet i mbetur nga viti 2024 i shtohet vitit 2025. Mgjith shpjegimet më të hollësishme do ti jap përfaqësuesja e bashkisë.

Znj. Pranvera Cina

Një nga arsyet kryesore të këtyre mosrealizimeve janë sepse këto investime bëhen me procedurë prokurimi dhe një sërë investimesh prioritare që kanë qënë për 2024, që kanë patur peshën më të madhe të fondeve, nuk janë realizuar me sukses për 2024, ndërkohë që ky investim ishte planifikuar të realizohej dhe të likujdohej gjatë vitit 2024. Ose një pjesë e tyre është lidhur kontrata në dhjetor 2024 dhe likujdimi mbetet për vitin 2025. Këto janë ndër arsyet më kryesore.

Znj. Evisa Sema

Po flas nga ana proceduriale. Një investim psh në një rrugë është planifikuar 200 milion lekë të vjetra. Kur prokurohet fiton ai që bënë ofertën me vlerë më të ulët dhe vlera më e ulët ta zëmë është 180 milion lekë të vjetra dhe diferenca prej 20 milion lekë të vjetra që mbeti nga ky prokurim do të trashëgohet për vitin tjetër dhe unë këtu po flas nga eksperiencia ime si kryetare e këshillit të Qarkut Fier.

Znj. Antoneta Çunaj

Kush është dakort për ta hedhur në votim?

Pro 34 vota.

Kundra 3 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

### **Pika e pestë e rendit të ditës.**

Projekt vendim "Për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.141, datë 23.12.2024 "Për miratimin e bursave të shtetit, për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin bazë dhe të mesëm për vitin shkollor 2024-2025"

stacionit të Hoxharës (Nën stacioni dhe vendosje shtylle) dhe dhënia në përdorim për shtrimin e linjës së re 220 KV dopjo Qark Fier- Hoxharë me përcjellës ACSR 490/65”

Znj.Antoneta Çunaj

Kush do të flasi nga administrata e bashkisë?

Z.Arbion Behari

Ju këtu në këshillin bashkiak në mbledhjet e mëparëshme ku i keni dhënë miratimin OST-së për ndërtimin e një linje që kalon në fondin pyjor të bashkisë Fier. Duke qënë se pas marrjes së vendimit dhe dërgimit të tij tek OST-ja është kërkuar nga ana e tyre që të bëhen disa specifikime ku të përcaktohen numrat e parcelave të fondit pyjor dh për këtë është risjellë ky material në këshillin bashkiak.

Z.Endri Jaupaj

Ju e keni trajtuar këtë projekt vendim?

Z.Arbion Behari

Jo nuk e kam trajtuar unë.

Z.Endri Jaupaj

Po atëherë pse e diskutoni ju kur nuk keni lidhje me këtë projekt vendim.Duhet ta trajtojë drejtorja që e ka sjellë këtë projekt vendim.

Z.Arbion Behari

Unë e relatoj sepse si drejtor i pronave në bashkinë e Fierit, prona në të cilën do të kalojë linja pavarësisht se i përket fondit pyjor është pronë e bashkisë Fier.

Z.Melsi Bogdani

Nqs keni pyetje apo paqartësi drejtjani pyetjet dy nënkryetarëve të bashkisë.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Mundem që të flaës edhe unë në cilësinë e drejtoreshës juridike të bashkisë Fier mqs edhe unë kam firmën tek ai projekt vendim? Po ta shikoni me kujdes vendimi I këshillit I cili është miratuar mbledhjet e kaluara shoqërohet me një relacion mjaftë të detajuar si dhe një raport tekniko-financiar, që zotëria si këshilltarë që është është njohur me të me trajtimin që I është bërë në mbledhjet e mëparëshme. Në kohën që merret leja nga OST-ja I kërkohet administratës së bashkisë një shtesë për plotësimin e VKB-së me disa të dhëna për pasurinë e cila është ajo që po I propozohet që ti shtohet vetëm pikës një të vendimit.Kurse pika dy e vendimit do të mbetet plotësisht e pandryshuar ashtu sikurse është miratuar në mbledhjen e këhillit.Edhe ndryshimi që kërkohet të bëhet është referuar në relacion edhe shkresa e Ministrisë së Mjedisit që e kërkon këtë plotësim.E miratoni apo jo ne do ti kthejmë përgjigje ministrisë në lidhje me vendimin.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 36 vota.

Sikurse u theksua nga përfaqësuesja e komisionit, kryetari i këtij komisioni nuk është present për arsye personale dhe në mungesë të tij foi zonja paraardhëse.E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim

### **Pika e nëntë e rendit të ditës.**

Znj.Antoneta Çunaj

Pika nëntë e rendit të ditës tërhiqet sikurse e thashë dhe në fillim nga administrata për plotësim dokumentacioni. Tani do të marrim në shyrtrim dy pikat shtesë të rendit të ditës, ndërsa pikën 10 të tij do ta lëmë për në fund, mqs është thjesht një informacion.

### **Pika e parë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për miratimin e planvendosjes së strukturës për projektin “Rehabilitimi i Lumit Gjanica Faza 3 , Fier” për efekt të vazhdimit të procedurave për pajisjen me leje infrastrukture dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajshme për shpronësim për interes publik”

Znj.Antoneta Çunaj

Ka ndonjë pyetje në lidhje me këtë project vendim?

Z.Endri Jaupaj

Kur bëhe fjalë për shpronësimet kuptohet që çështja qështë sensitive. Prona është një gjë e shenjtë dhe këtu patjetër duhet të kishte një komision që të ishte mbledh, të kishte përgatitur një relacion dhe të kishim një informacion më shumë me mënyrën si është negociuar, çmimet e shpronësimit pra çdo gjë.Sepse qytetari duhet të marri atë që i takon.Sepse ne këtu jemi duke marrë një vendim pppër një pronë që po ja shpppronësojmë dikujt dhe kjo është një gjë shumë sensitive.

Znj.Antoneta Çunaj

Çmimet e shpronësimeve janë të përcaktuar në VKM dhe këshilli bashkiak nuk mund të japi më shumë sesa jep VKM-ja.

Znj.Yllka Sheshi

Pronarët e truallit që do të merret nga shteti a janë dakortë që ta japin këtë truall?

Znj.Antoneta Çunaj

Për shpronësimet që bën shteti nuk merret dakortësia e pronarëve.

Z.Gëzim Hajdëraj

Më falni kryetare por unë nuk e kuptojë dot këtë termin në project vendimin “miratimi planvendosja e strukturës së projektit”. Për mua ky term nuk ka kuptim dhe unë nuk jam shumë i qartë prandaj dhe do të doja sqarimin e administratës në lidhje me përdorimin e këtij termi të përdorur dhe konkretisht çfarë kuptojmë me të, sepse për mua planvendosja është pozicionim i një trualli në një hartë të caktuar dhe këtu nuk kemi bashkëlidhur asnjë

hartë dhe anjë document tjetër. Nqs projekti ka planvendosje atëherë çfarë planvendosje do të miratojmë ne? Nqs projekti është miratuar se ku do të shtrihet atëherë çfarë planvendosje do të miratojmë. Nuk ka projekt pa planvendosje kështu që ne nuk kemi çfarë miratojmë. Derisa nuk ka asnjë projekt pa planvendosje dhe dosja është atje e plotësuar atëherë kalon direct procedura e shpronësimit dhe nuk ka nevojë për këtë project vendim që keni paraqitur këtu.

Z.Erald Tavanxhiu

Në lidhje me projek vendimin e lumit të Gjanicës po vazhdojmë me fazën e tretë të rehabilitimit të lumit Gjanica...

Z.Gëzim Hajdëraj

Më falni, kush është ky ekspert që është duke folur?

Znj.Antoneta Çunaj

Është arkitekti që është pjesë e grupit të projektimit.

Z.Gëzim Hajdëraj

Nuk merremi ne me arkitektë e specialist këtu.Sikurse e tha dhe kolegu parafolës Z.Jaupaj dhe unë jam dakortë me të në këtë pikë. Të gjitha këto projekte që sillen për tu miratuar në këshill duhet të paraqiten dhe të relatohen minimalisht nga titullarët e drejtorive përkatëse. Për mua të gjitha këto project vendime duhet të paraqiten dhe të relatohen nga kryetari i bashkisë, në mungesë të kryetarit kjo gjë duhet të bëhet nga nënkryetarët e bashkisë. Këtu të dy nënkryetarët janë present dhe kanë gjithë mbledhjen që nuk po flasin fare, mqs nuk është kryetari.Pra ky project për mua duhet të relatohet nga nënkryetari i bashkisë sepse ne nuk merrremi me arkitekt e më the , të thashë. Arkitekti jep sqarime në administratën e bashkisë përpara titullarit, pra i jep sqarime administratës së bashkisë dhe jo ne këtu në këshill.Këhtu që unë mendoj që për të vazhduar më tej procedurën, ne këto sqarime duhet të na japi ose kryetari i bashkisë dhe në mungesë të tijë nënkryetarët e bashkisë sepse ata përfaqësojnë bashkinë. Ne i marrim sqarimet vetëm nga këta persona dhe jo nga arkitekti apo ndonjë specialist tjetër.Ata flasin me arkitektë dhe me specilistët e tjerë për të sqaruar materialet përpara titullarëve të tyre. Jo arkitekti të japi sqarime anëtarëve të këshillit sepse kjo gjë nuk është fare serioze.Kështu ne nuk e respektojmë ligjin dhe rregulloren sipas së cilës vetëm kryetari dhe nënkryetarët me porosi të kryetarit japin sqarimet për materialet në mbledhjet e këshillit.

Z.Vasil Bregu

Për këtë pikë, ju sqaroj se është miratuar fondi me BERZH-in për financimin e projektit të fazës së tretë të projektit të rehabilitimit të lumit Gjanicë, project I cili është me interes për të gjithë ne qytetarët e Fierit. Për këtë kërkohet miratimi I gjurmës ku do të kalojë projekti që është bërë dhe duhet miratimi I këshillit për të marrë më pas lejen për të zhvilluar punimet. Financimi është nga FSHZH-ja.Nga ana jonë kërkohet që brenda këtij projekti , për ato objekte që mund të preken nga shtrirja dhe zhvillimi i këtij projekti siç është bërë deri tani. Nqs do të ketë truaje apo objekte, shpronësimi i tyre do të bëhet sipas VKM-së përkatëse.Financimi është I miratuar si financim kërkohet nga ana jonë vetëm miratimi I gjurmës.

Z.Gëzim Hajdëraj

Desha të pyes,si e kuptoni ju nga ana gjuhësore“miratimi planvendosja e strukturës së projektit”

Z.Vasil Bregu

Është bërë një lapsus, nënkupton planvendosjen e gjurmës së projektit.

Z.Gëzim Hajdëraj

Për mua, unë e kam thënë edhe në mbledhjen e parëkur është diskutuar projekti i Gjanicës. Pavarësisht se nënkryetari i bashkisë tha që kjo është për të mirën e gjithë komunitetit të Fierit, për mua kjo është për të mirën e asaj pjese të komunitetit ku shtrihet projekti e cila është një pjesë shumë e vogël që do të dalin atje për të bërë ecje buzë Gjanicës. Unë mendoj që bashkia duhet të ketë prioritete të tjera kur merr fonde nga BERZH-I sepse nuk merret një fond kaq i madh për të bërë lumin Gjanica, atë pjesën atje që është fare e papërfillëshme e cila është në një pozicion shumë anësor të komunitetit Fierak. Qyteti i Fierit ka plotë prioritete të tjera. Ka lagje si lagjia "1 Maj" që nuk ka rrugë fare, që është tmerr. Ka prioritete dhe probleme të tjera dhe duhet bashkia të kërkojë fonde nga BERZH-I për prioritetet dhe problemet kryesore të qytetit të Fierit.

Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit! Duhet të sqaroj të nderuar këshilltarë që kjo është faza e tretë e projektit dmth janë përfunduar dy fazat e para të projektit, e para,dhe e dyta , vetë donatorët e mëdhenj, pasi këto nuk janë fonde të bashkisë, e vendosin vetë cilin nga projektete e paraqitura do të mbështesin.

Znj.Yllka Sheshi

Zotërinë e dëgjova dhe vërtetë aim und të thotë për lagjen 1 Maj që është me rrugë jo të mira, por ka edhe me keq që ka zona të qytetit që nuk kanë kanalizimet e ujërave të zeza si dhe rrjet ujësjellësi.Me të drejtë ai tha që kjo gjë është një gjë që edhe mund të presi por prioriteti I bashkisë duhet të jenë këto gjëra që unë sapo thashë më sipër që ti vijë në ndihmë komunitetit.

Z.Endri Jaupaj

Është bërë dëgjese publike për këtë?

Znj.Antoneta Çunaj

Në këtë fazë ku jemi nuk ka dëgjese publike ajo është bërë që në fazën fillestare të projektit.

Z.Arben Çuko

Kam një pyetje për Eraldin. Erald janë parashikuar kangjella mbrojtëse tek skrapata e lumit Gjanica në të dyja anët e tij, pasi është shumë e thepisur dhe e rrezikshme për fëmijët? Dhe së dyti, tek hotel Fieri, tek ura janë thyer xhamat e saj, kush I ka projektuar ato? Më mirë të hiqen fare dhe të vihen kangjella pasi është shumë e rrezikshme. Atje potuajse është një po dhe një jo nga xhamat.Kështu që duhet të marri masat bashkia menjëherë, pasi mund të ndodhë ndonjë fatkeqësi, të bjeri ndonjë fëmijë dhe të vritet.Faleminderit!

Z.Erald Tavanxhiu

Të falenderoj që kërkon informacion nga grupi teknik që ka bërë projektin.Në rast se dikush këtu bënë një pyetje teknike dhe i drejtohet kryetarit të bashkisë, mua një gjë e tillë nuk më duket korrekte. Nuk e ka kryetari i bashkisë informacionin e nevojshëm për të dhënë përgjigje për pyetjet teknike.

Z.Gëzim Hajdëraj

Zonja kryetare, për procedurë. Ju thashë dhe njëherë, lexoni rregulloren. Nuk marrin fjalën në këshill specialistët e bashkisë as staf i administrativë i bashkisë. Fjalën në këshill e marri ose kryetari ose nënkryetarët e bashkisë. Nqs një anëtar këshilli do të bëjë sqarime me specialistët, me të marrë materin ka të drejtën ti bëjë një kërkesë bashkisë dhe të marri sqarimet e nevojshme.

Z.Arben Çuko

E bëra pyetjen pasi ndoshta nuk i ka vënë firma që ka marrë tenderin kangjellat mbrojtëse dhe është në dijeni bashkia për këtë problem? Pyetja ishte teknike dhe nuk mund ti japi përgjigje sipas mendimit tim kryetari apo nënkryetarët për pyetjet teknike.

Z.Gëzim Hajdëraj

Kryetari apo nënkryetarët që kanë të drejtën të marrin fjalën në këshill dhe detyrimin për të sqaruar këshilltarët, përpara se të vijnë në këshill ti mbledhin specialistët, teknikienët dhe të marrin informacionin e duhur për të gjitha problematikat që do të trajtohen në mbledhjen e këshillit. Unë po sqaroj procedurën e parashikuar në rregullore për këtë problem.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën? Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

Thjeshtë një saktësim në drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Ka një rregull. Nqs para një emir të një personi shënohet prof. do të thotë që ai është profesor, nqs shënohet dr. do të thotë që ai është doktorë I shkencave. Unë pyes këta të katërt që kanë firmosur janë doktorë shkencash pasi përpara emrit të tyre është vendosur dr?

Znj.Antoneta Çunaj

Është shkurtimi që përdorë administrate e bashkisë për titullin drejtor drejtorie në bashki.

Z.Ilia Fili

Atëherë ju lutem korrigjoheni që të jemi korrekt në drejtshkrimin e gjuhës shqipe.

Znj.Antoneta Çunaj

Atëherë administrate duhet ta ketë parasysh vërejtjen e bërë dhe të shënojë drejtor dhe jo dr përpara emrit të titullarit të saj. Ta hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

/

Projekt vendim "Për dhënien e miratimit për prishjen e objektit "vendstrehim" me sipërfaqe 135 m<sup>2</sup>, me nr. inventari 664, zk. 8531, që preket nga projekti "Shtesë anësore 1 kt në objekt ekzistues 3 kt, shkolla 9 vjeçare "Liri Gero" lagja "11 Janari" Fier, për ndërtimin e palestrës së shkollës si dhe nxjerrjen nga inventari të kësaj pasurie"

ZnjAntoneta Çunaj

Fjalën e ka përfqësuesi i bashkisë.

Z.Arbion Behari

Nga ana e drejtorisë së projekteve është hartuar një project për ndërtimin e palestrës së shkollës "Liri Gero" projekt cili nga zbatimi në terren ka hasur në vështirësi për shkak të ekzistencës së një vendstrehimi me nr. 664 inventari , I cili është pronë e bashkisë Fier dhe që ndodhet brenda territorit të kësaj shkolle.Në kuadër të zbatimit të këtij projekti është kërkuar miratimi për prishjen e këtij vendstrehimi.Duke qënë se në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miratimi për prishjen e këtij vendstrehimi merret nga Ministria e Mbrojtjes, i kemi kërkuar konfirmimin Ministria e Mbrojtjes për prishjen e këtij vendstrehimit.Pas ngritjes së grupeve të punës dhe verifikimit në terren është marrë vendimi dhe është dhënë miratimi për prishjen e vendstrehimit në kuadër të zbatimit të projektit dhe duke qënë se vendstrehimi sipas arsytimit të tyre e ka humbur funksionin për të cilin ka ekzistuar, është dhënë miratimi për prishjen e këtij vendstrehimi.Duke qënë se ky vendstrehim është pronë e bashkisë Fier bazuar në projektin e hartuar si dhe në miratimin e marrë nga Ministria e Mbrojtjes, I propozojmë këshillit miratimin e procedurës për prishjen e këtij vendstrehimi dhe autorizimin e ekzekutivit për nxjerrjen nga inventari të këtij vendstrehimi.

Z.Endri Jaupaj

Kemi relacion të komisionit për këtë pikë të rendit të ditës? Pra është mbledhur komisioni?

ZnjAntoneta Çunaj

Sikurse e kam theksuar disa herë, të gjithë anëtarët e këshillit dhe përfaqësuesit e komisioneve janë të lirë të kërkojnë fjalën dhe të flasin kur ta gjykojnë të arsyeshme në lidhje me pikat e rendit të ditës.Në lidhje me këto pikë ka ndonjë këshilltarë tjetër apo përfaqësues nga komisini që e do fjalën?Mqs nuk ka atëherë e hedhim në votim.Kush është dakort me këtë project vendim?

Pro 31 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim 5 vota.

Miratohet

### **Pika e dhjetë e rendit të ditës.**

Informacion "Mbi raportin e monitorimit 12-mujor të buxhetit të bashkisë Fier për vitin 2024"

ZnjAntoneta Çunaj

Kjo pikë e rendit të ditës është thjeshtë një informacion për këshillin I cili ju është përcjellë edhe juve si këshilltarë në mënyrë elektronike.Nëse ka pyetje apo sqarime secili nga ju mund ti drejtohet administratës sepse ky është thjeshtë një informacion që I bëhet me dije këshillit dhe nuk ka nevojë për vendimarrje nga këshilli.

Z.Ilia Fili

E para, mua nuk më ka ardhur informacioni i mësipërm.

ZnjAntoneta Çunaj

Nuk është e vërtetë.

Z.Arnando Çupa

Në mënyrë elektronike u është shpërndarë në grup të gjithë këshilltarëve. Fizikisht cilido këshilltarë që ka shfaqur interes për këtë informacion e ka patur të disponueshëm pranë sekretariatit të këshillit.

Z.Endri Jaupaj

Kur është dërguar?

Z.Arnando Çupa

Në momentin që është depozituar pranë sekretariatit të këshillit ju është dërguar elektronikisht. Pra sapo ka ardhur informacioni unë e kam dërguar atë tek ju elektronikisht.

Z.Ilia Fili

Ju lutem mund të flisni? Është hera e dytë që na vjen ky informacion. Informacioni i parë ishte ai për vitin 2023 dhe ne e shqyrtuam në fillim të vitit 2024 dhe tani vjen 2024 për tu shqyrtuar në fillim të 2025. Ky është një material pa asnjë lloj rëndësie derisa këshilltarët largohen nga salla. Atëherë edhe unë po e mbyll diskutimin dhe mos e sillni më për diskutim në këshill. Ky është dokumenti themelor i bashkisë, çfarë bëhet kështu?

ZnjAntoneta Çunaj

Është thjesht një informacion që i jepet këshillit. Kush ka pyetje dhe sygjerime mund ti drejtohet administratës së bashkisë. Ne si këshilltarë nuk kemi vendimarrje deri sa kemi të bëjmë thjesht me informacion.

ZnjAntoneta Çunaj

Faleminderit të gjithë këshilltarëve të pranishëm!

Ky proces verbal ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe, mbahet në tre kopje nga Sekretari i Këshillit Z. Arnando Çupa

**Sekretari i Këshillit**

**Arnando ÇUPA**

**Kryetar i Këshillit**

**Antoneta ÇUNAJ**

